



	
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësi:	Nr. Prot.:
Unit:	Prot. No.:
Jednica:	Br. Prot.:
Nr. i faqeve:	Data:
No. of pages:	Datum:
Br. stranica:	Prishinë/s

Handwritten entries: Unit: ZK, Prot. No.: 247/2019, No. of pages: -18-, Datum: 19.06.2019



Memorandum i bashkëpunimit

në mes të

Odës së Mjekëve të Kosovës – O M K

dhe

Kompanisë së Sigurimeve ” Sigal UNIQA Group Austria”

Prishtinë, Qershor 2019

Palët në këtë memorandum:

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS (në vazhdim nën akronim OMK) me seli në adresë QKUK, Instituti A kati III, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Kryetari i OMK-së, dr. Pleurat Sejdiu;

dhe

KOMPANIA E SIGURIMEVE “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.a., shoqëri aksionare e inkomporuar sipas ligjeve të Kosovës me NUI 811291484 me seli në adresë në Lagjen Pejton Rr. "Pashko Vasa" p.n., 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Saimir Dhamo.

Palët në këtë memorandum dakordohen si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

1. Ky Memorandum synon komunikimin në mes të subjekteve të këtij memorandumi lidhur me ofrimin e sigurimit të përgjegjësive profesionale për mjekët/anëtarë të OMK-së nga kompania e sigurimeve si palë këtë memorandum.
2. Memorandumi ka për qëllim veçanërisht që nga pala e cila ofron sigurime të përgjegjësive profesionale të paraqesë ofertë të veçantë për mjekët/anëtarët e Odës së Mjekëve të Kosovës, e cila është palë në këtë memorandum.

Neni 2

Fusha e bashkëpunimit

1. Palët dakordohen që me rastin e implementimin e këtij memorandumi të:
 - 1.1 Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria”, Sh.a., të kontraktojë sigurime të përgjegjësive profesionale sipas ofertës që i dorëzohet palës, OMK-së;
 - 1.2 Angazhimi i kompanisë që të lidhë kontratat individuale për sigurime të përgjegjësive profesionale sigurim sipas pakove të sigurimeve të përgjegjësive profesionale siç janë të parapara me shtojcën e veçantë me këtë memorandum;

- 1.3 Oda e Mjekëve të Kosovës ta paraqesë ofertën e Kompanisë përmes strukturës së saj organizative dhe mjeteve të brendshme të komunikimeve tek anëtarësia e saj, për të cilën me qëllim të ofrimit të çmimeve më të volitshme tu ofrohet mundësia e lidhjes së kontratave individuale për sigurime të përgjegjësive profesionale;
 - 1.4 Bashkëpunimi në mes të palëve në këtë memorandum të promovohet lidhur me rëndësinë e sigurimeve të përgjegjësive profesionale në shëndetin e përgjithshëm; dhe
 - 1.5 OMK-ja dhe Kompania e Sigurimeve "Sigal Uniqa Group Austria" do të angazhohen për efikasitetin e ndërsjellë në ofertimin e bërë nga ofertuesi.
2. Palët e këtij memorandum do të ndërmarrin veprimet e përshtatshme për nevojat e cekura në paragrafin 1 të këtij neni, sipas komunikimit të ndërsjellë.
 3. Oda e Mjekëve të Kosovës, si palë e këtij memorandum, nuk mbanë asnjë përgjegjësi lidhur me raportin kontraktual në mes të sigurvearit dhe të siguruarit, i cili është anëtar i saj dhe nuk garanton ndonjë rezultat preliminar të kontraktimit kolektiv.

Neni 3 **Mënyra e komunikimit**

1. Palët dakordohen që për çdo çështje të kontaktojnë përmes zyrtarëve të autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Palët do t'ia komunikojnë zyrtarëve të tyre për komunikim përmes shkresës zyrtare të autorizuar nga organi kompetent i palës.
2. Komunikimi në mes të zyrtarëve të autorizuar do të realizohet, por nuk do të kufizohet, përmes takimeve të drejtpërdrejta si dhe përmes komunikimit formal përmes postës dhe komunikimit elektronik.
3. Adresat zyrtare të komunikimit janë:

3.1 **Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK) - E-mail: info@omk-rks.org ; nr. tel. 049/872 300.**

3.2 **Kompania e Sigurimeve "Sigal Uniqa Group Austria" Sh.a. : E-mail: info@sigal-ks.com nr. tel. +383 38 240 241.**

Neni 4 **Kohëzgjatja e memorandumit**

Ky Memorandum lidhet në afat të pacaktuar dhe i njëjti mund të zgjidhet vetëm me marrëveshje ndërmjet palëve në memorandum.

Neni 5 Hyrja në fuqi

1. Secila palë në këtë memorandum do të disponoj nga 1 (një) ekzemplar në origjinal të këtij memorandum.
2. Memorandumi i mirëkuptimit në mes të **Odës së Mjekëve të Kosovës** dhe **Kompanisë së Sigurimeve "Sigal Uniqa Group Austria" Sh.a.**, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij sipas datës së stipuluar në këtë memorandum.
3. Në kuadër të Memorandumit të nënshkruar nga OMK dhe Sigal Uniqa, palët janë dakorduar që me rastin e kontraktimit të sigurimit të përgjegjësive profesionale nga mjekët individualisht, Sigal Uniqa do të ofrojë në pako edhe sigurimin Mini-Kasko si produkt shtesë pa pagesë, në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ofertë.
4. Nga sa më sipër, në frymën e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Sigal Uniqa dhe OMK, Sigal Uniqa ofron produktin e sigurimit MiniKasko falas për të gjithë anëtarët e Odës së Mjekëve të cilët kontraktojnë përgjegjësinë profesionale. Meqenëse MiniKasko është produkt shtesë i Autopërgjegjësive, ai do t'i ofrohet në momentin e blerjes së policës së autopërgjegjësive në Sigal Uniqa.

Data: 19.06.2019

PALËT NËNSHKRUESE

Për:
Odën e Mjekëve të Kosovës

Dr. Pleurat Sjediu, Mr. sci
Kryetar i OMK-së



Për
Kompania e Sigurimeve "Sigal Uniqa
Group Austria" Sh.a.

Z. Saimir Dharmo
Kryeshef Ekzekutiv



Pergjegjesi Profesionale "Sigurimi i neglizhencës mjekësore"
Formulari i Polices Nr. _____

Kompania e Sigurimit "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" sh.a. në përputhje me kushtet, përcaktimet, përjashtimet dhe parashikimet e kushteve të përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale (Sigurimi i Neglizhencës Mjekësore) dhe kësaj police, do të dëmshpërblejë: _____" për te gjithë shumen e cila është ligjrisht e detyrueshme për zhdëmtimin e shpenzimeve dhe kostove të pretenduesit për cdo ngjarje të siguruar për të cilën aplikohet kjo policë dhe brenda limiteve të zhdëmtimit për dëmtime trupore (cdo plagë në trup, dëmtim mendor, sëmundje) ose humbje Jete (vdekje) e personit të tretë kundrejt pagesës së primit të sigurimit:

Primi € _____ plus TVSH € _____ Total € _____, Paguar date ____/____/____

Me kusht që pergjegjësia e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. sipas kesaj police nuk i tejkalon:

Limitet Maksimale te Dëmshpërblimit:

- **DEMTIME TRUPORE PER CDO PERSON EUR _____**
- Humbje Jete per cdo person **EUR _____**
- Agregati vjetor (Te gjitha demet Brenda periudhes sigurimit) **EUR _____**

Ngjarja e Siguruar: Neglizhence "Çdo plagë në trup, dëmtim mendor, sëmundje, ose humbje Jete (vdekje) të çdo pacienti shkaktuar si rezultat i drejtpërdrejtë i neglizhencës, gabimit ose mosveprimit gjatë drejtimit dhe zbatimit të veprimtarisë të profesionistit shëndetësor të kryer nga ju.,

a. në performancën e një aktiviteti të punës; ose

b. gjatë kohës së Aktit të Samaritanit.

Aktiviteti i Biznesit: _____

Pjesa e Zbritshme: ____% per ngjarje, minimumi € _____ (per cdo ngjarje)

Periudha e Sigurimit: Nga: ora 24.01 te dates ____/____/____

Deri ne: Ora 24.00 te dates ____/____/____ te dyja datat e perfshira.

Territori: Kosove

Vendndodhja e Aktivitetit: _____

(Kjo police mbulon deme te shkaktuara pas dates se fillimit dhe Brenda periudhes se sigurimit te kesaj police)

Leshuar ne Prishtina date ____/____/____

Ne emer te siguruesit dhe te Siguruarit nenshkruajne

SIGURUESI

I SIGURUARI

G.K.

P.S

Termet dhe Kushtet e Përgjithshme

Përkufizimet e përgjithshme	<p>Fjalët e shquara me të zezë të theksuar kanë të njëjtin kuptim kurdoherë kur ato shfaqen në këtë policë.</p> <p>Fjalët e përkufizuara më poshtë përdoren përgjatë të gjithë kësaj police. Çdo përkufizim tjetër do të shfaqet në seksionin në të cilin ato do të jenë të vlefshme.</p>
Rreziqet e asbestit	<p>a. punimet minerale, përpunimi, fabrikimi, përdorimi, testimi, zotërimi, shitja ose heqja e asbestit, fibrave të asbestit ose të materialeve që përmbajnë asbest; ose</p> <p>b. ekspozimi ndaj asbestit, fibrave të asbestit ose materialeve që përmbajnë asbest; ose</p> <p>c. ofrimin e udhëzimeve, rekomandimeve, njoftimeve, paralajmërimeve, mbikëqyrjen ose këshillimin e dhënë, ose që duhet të ishte dhënë, në lidhje me asbestin, fibrat e asbestit, ose strukturat ose materialet që përmbajnë asbest</p>
Biznes	Biznesi ose profesioni juaj siç tregohet në plan.
Konfiskim	Konfiskim, shtetëzim, blerje ose shkatërrim i ose dëmtim ndaj pronës nga, ose me udhëzim të, çdo autoriteti shtetëror ose publik ose vendor.
Data e njohur	Çdo mosfunksionim i çdo paisje (duke përfshirë çdo pjesë elektronike ose programi elektronik) për të njohur me saktësi çdo datë të dhënë ose për të përpunuar çdo të dhënë ose për të operuar me saktësi si pasojë e mosfunksionimit për të njohur me saktësi çdo datë të dhënë.
Miratim	Një ndryshim në termat e policës .
Tejkalim	Shuma që ju duhet të mbani si pjesë të parë të çdo pretendimi për të cilën është rënë dakord.
Kufizimet gjeografike	Zona gjeografike siç tregohet në planin e punës.
Rreziqet bërthamore	<p>a. çdo lloj materiali bërthamor, reaksioni bërthamor, rrezatimi bërthamor ose ndotjeje bërthamore;</p> <p>b. çdo produkt ose shërbim që përfshin, ose që lidhet në çdo mënyrë me çdonjërin nga pikat (a) më sipër, ose magazinimin, trajtimin ose hedhjen e çdonjërit nga pikat (a) më sipër;</p> <p>c. të gjitha operacionet e kryera në çdo vend të punimeve apo të godinave në të cilën ndodhet çdonjëra në pikat (a) ose (b).</p>
Periudha e sigurimit	Koha në të cilën kjo policë është në fuqi siç tregohet në këtë plan.
Policë	Ky dokument sigurimi dhe plan, duke përfshirë çdo miratim .
Terrorizem	<p>Çdo veprim, ose kërcënim i një veprimi. Nga çdo person ose grupi personash, qoftë nëse vepron i vetëm ose në emër të ose në lidhje me çdo organizatë ose qeveri, që:</p> <p>a. kryhet për qëllime politike, fetare, ideologjike, ose për qëllime të tjera të ngjashme; dhe</p> <p>b. synon influencimin e ndonjë qeverie ose për të frikësuar publikun ose çdo seksion të publikut; dhe</p> <p>c. i. përfshin dhunë kudër një ose më shumë personave; ose</p> <p>ii. përfshin dëme ndaj pronës; ose</p> <p>iii. rrezikon jetë tjetër përveç atij që është duke kryer veprimin; ose</p> <p>iv. krijon një rrezik ndaj shëndetit ose sigurisë së publikut ose të një seksioni të publikut; ose</p> <p>v. është hartuar për të ndërhyrë me ose për të ndërprerë një sistem elektronik.</p>
Virus	Një copëz kodi i ekzekutueshëm i paautorizuar që shumon vetveten nëpërmjet sistemit ose rrjetit tuaj të kompjuterit.

G. K.

P. S.
1

Luftë	Luftë, pushtim, akt armiqsh të jashtëm, arkmiqësi (qoftë nëse deklarohet luftë apo jo), luftë civile, rebelim, revolucion, kryengritje, fuqi ushtarake ose pushtuese.
Ne/ jona/ e jona	Siguruesit e emërtuar në plan.
Ju / juaja	I siguruari i emërtuar në plan.

Precedentët e Kushteve

Kushte e Përgjithshme 2, 3 dhe 4 më poshtë, Kushti i Përgjithshëm i Ankesave I dhe kushte e treguara më poshtë në çdo seksion nën titullin **Detyrimet Tuaja** janë të gjitha precedent kushtesh ndaj përgjegjësive **tonë**.
Ne nuk do të kryejmë asnjë pagesë sipas këtij sigurimi në rast se **ju** nuk ankoheni me të gjitha kërkesat ndaj këtyre kushteve.

Kushtet e Përgjithshme

Kushtet e mëposhtme aplikohen ndaj të gjithë **policës**. Çdo kusht tjetër shfaqet në seksionin tek i cili ai do të jetë i vlefshëm.

Bazat e sigurimit	<p>1. Për shkak të rëndësisë së saj, i gjithë informacioni që ju ose ëdo njeri tjetër në emrin tuaj që është dhënë përpara se ne të binim dakord për t'ju siguruar ju është përfshirë dhe formon bazat e kësaj police.</p> <p>Të gjitha faktet dhe çështjet që mund të jenë të rëndësishme për konsideratën tonë lidhur me propozimin tuaj duhet të hapen dhe të gjitha përfaqësimet materiale që janë bërë ndaj nesh duhet të jenë të vërteta, përndryshe ne kemi të drejtën për t'a trajtuar këtë sigurim sikur të mos kishte ekzistuar kurrë.</p>
Ndryshimi i rrethanave	<p>2. Ju duhet të na tregoni sa më parë që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme për çdo ndryshim rrethanash gjatë periudhës së sigurimit e cila mund të çënojë materialisht këtë policë. (Një fakt material ose rrethanë është një që mund të çënojë vendimin tonë për të ofruar sigurim ose kushtet e këtij sigurimi.) Ne më pas mund të ndryshojmë termat dhe kushtet e kësaj police.</p>
Vigjilenca/Kujdesi i kërkuar	<p>3. Ju duhet të ndërmerri hapa të arsyeshëm për të parandaluar aksidentin ose plagosjen dhe për të mbojtur pronën/pegjegjesine tuaj kundrejt çdo humbje ose demtimi. Ju duhet ta siguroni çdo pronë/pegjegjesi nën këtë policë në kushte të mira dhe të riparuar.</p>
Pagesa e primit	<p>4. Ne nuk do të kryejmë asnjë pagesë nën këtë policë në rast se ju nuk e keni paguar primin.</p>
Anullimi	<p>5. Ju ose ne mund ta anulojmë policën nëpërmjet një njoftimi me shkrim prej 30 ditësh. Ne do t'ju rimbursojmë juve primin për periudhën e mbetur.</p> <p>Nëse ne kemi rënë dakord se ju mund ta paguani primin tuaj ndaj nesh me këste dhe ne nuk e kemi marrë një këst 14 ditë pas datës së pagesës, ne mund ta anulojmë policën. Në këtë rast, periudha e sigurimit do të barazojë periudhën për të cilën janë paguar këstet e primit ndaj nesh. Ne do të konfirmojmë anulimin dhe periudhën e ndryshuar të sigurimit ndaj jush me shkrim.</p>
Sigurim i shumëfishtë	<p>6. Shuma më e madhe që ne do të paguajmë është shuma e përshtatshme që tregohet në formularin e policës. Nëse emërtohet më shumë sesa një i siguruar në formular, shuma totale që ne do të paguajmë nuk do ta tejkalojë shumën që ne do të ishim përgjegjës për t'ju paguar ndonjërit prej jush.</p> <p>Ju bini dakord që i suguruari i emërtuar në Formulare, ose nëse ka më shumë sesa një të siguruar të emërtuar në plan, i pari prej tyre, është i autorizuar për të marrë të gjitha njoftimet dhe të bie dakord mbi çdo ndryshim të policës.</p>
Kufiri agregat	<p>7. Ku kjo policë specifikon një kufi agregat, kjo do të thotë se pagesa jonë maksimale për të gjitha pretendimet e përshtatshme ose humbjete e mbuluara nën këtë policë gjatë periudhës së sigurimit.</p>

G. K.

P.S

Nëse **periudha e sigurimit** është e vazhdueshme, kufiri agregat do të jetë i vlefshëm ndaj të gjitha pretendimeve të përshtatshme ose humbjeve të mbuluara nën këtë **policë** gjatë 12 muajve nga data kur fillon mbulimi i vazhdueshëm. Çdo kufi agregat do të rikthehet në nivelin e treguar në planin e çdo përvjetori.

Të drejtat e palëve të treta

8. **Ju** dhe **ne** jemi të vetmet palë të kësaj **police**. Asgjë në këtë **policë** nuk ka për qëllim që t'i japë çdo personi ndonjë të drejtë për të imponuar ndonjë term të kësaj **police** që ai person nuk do ta kishte pasur po të mos ishte ky Ligj (Të drejtat e Palëve të Treta) Kontraktor 1999.

Sigurim tjetër

9. Kjo **policë** nuk mbulon asnjë humbje ose pretendim ku **ju** do të kishit të drejtën që të paguheshit sipas çdo sigurimi tjetër nëse kjo **policë** nuk do të ekzistonte.

Ligje shtetërore

10. Vetëm në rast nëse është dakordësuar me shkrim ndonjë ligj tjetër, kjo **policë** do të udhëhiqet nga ligjet e **Republikës së Kosovës**.

Mosmarrëveshjet

11. Çdo mosmarrëveshje që mund të ngrihet ose në lidhje me këtë policë, duke përfshirë ndërtimin, aplikimin dhe vlefshmërinë e saj, do të referohet në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Kushtet e Përgjithshme të Pretendimeve

Kushtet e pretendimeve të mëposhtme janë të aplikueshme për të gjithë këtë **policë**. Çdo kusht tjetër pretendimesh dhe procedurash tregohen në seksionin në të cilin ato do të jenë të aplikueshme.

1. Detyrimet tuaja

Ne nuk do të kryejmë asnjë pagesë nën këtë **policë** në rast se **ju** nuk:

- të na njoftoni **ne** menjëherë për çdo gjë që ka të ngjarë që të jetë shkak i ngritjes së një pretendimi për dëmshpërblim sipas kësaj **police**, në përputhje me termat e çdo seksioni;
- të na paraqisni **ne**, me shpenzimet **tuaja**, çdo informacion të cilin **ne** mund t'a kërkojmë në mënyrë të arsyeshme dhe të bashkëpunoni plotësisht në hetimin e çdo pretendimi sipas kësaj **police**;
- të kryeni çdo përpjekje të arsyeshme për të minimizuar çdo humbje, dëmtim ose përgjegjësi dhe të ndërmerri masat e përshtatshme emergjente menjëherë nëse ato kërkohen për të reduktuar çdo ankesë;
- të na jipni **neve** të gjithë mbështetjen që **ne** mund ta kërkojmë në mënyrë të arsyeshme **për të** ndjekur rikthimin e shumës të cilën **ne** mund të bëhemi përgjegjës për t'a paguar sipas kësaj **police**, në emrin tuaj por me shpenzimet **tona**.

2. Nëse **ju**, ose çdonjeri në emrin **tuaj**, përpiqet që të na mashtrorë **ne** duke dhënë qëllimisht informacion fallco ose duke bërë një pretendim mashtrues sipas kësaj **police** atëherë **ne** do ta trajtojmë këtë **policë** sikur ajo të mos kishte ekzistuar kurrë.

G. K.

P.S.

Sigurimi i neglizhencës mjekësore

Termtat dhe kushtet e përgjithshme dhe termtat dhe kushtet e mëposhtme janë të gjitha të aplikueshme në këtë seksion.

Përkufizime të veçanta për këtë seksion

Aktivitet biznesi	Aktivitetet e treguara në këtë formular, ose pyetesor, ose në përfaqësimet materiale të dakordësuara nga ne, që ju e kryeni gjatë punës suaj .
Kostot e mbrojtjes	Kostot e ndodhura me miratimin tonë paraprak në formë të shkruar për të hetuar, zgjidhur ose mbrojtur një pretendim kundër jush , duke përfshirë përfaqësimin me kërkesë të një hetuesi, si pasojë e vdekjes së ndonjë pacienti tuaj .
Neglizhencë	Çdo plagë në trup, dëmtim mendor, sëmundje, ose vdekje të çdo pacienti shkaktuar nga një veprim, gabim neglizhence ose përrjashtim të kryer nga ju : a. në performancën e një aktiviteti të punës; ose b. gjatë kohës së Aktit të Samaritanit .
Akti i Samaritan-it (ose mirëbërësit)	Trajtim i administruar nga ju në skenën e një urgjence mjekësore, aksidenti ose fatkeqësi në të cilën ju jeni të pranishëm ose rastësisht ose në përgjigje të një telefonate emergjence (S.O.S) që pason një fatkeqësi.
Ju / juaj	Gjithashtu përfshin çdo njeri që ka qenë, është ose do të jetë gjatë periudhës së sigurimit bëhet drejtori juaj partner, menaxher i lartë, punonjës, anëtar i komitetit të etikës, ose vullnetar që performon aktivitetet gjatë kohës së punës suaj .

Çfarë mbulohet

Ankesat kundër jush

Nëse gjatë **periudhës së sigurimit**, dhe si rezultat i **aktivitetit tuaj të punës** brenda kufinjëve gjeografikë për klientët, çdo palë paraqet një kërkesë kundër **jush** ose një punonjësi **tuaj** ose vullnetari për:

- a. **neglizhencë**;
- b. neglizhencë ose thyerje gjatë një detyre/funksioni kujdesi;
- c. pandershmeri të partnerëve **tuaj** individualë, drejtorëve, punonjësve ose konsulentëve të vetëpunësuar të kontraktuar drejtpërsëdrejti për **ju** dhe nën mbikëqyrjen **tuaj**;

ne do t'ju dëmshpërblejmë **ju** kundrejt shumave që **ju** duhet të paguani si kompensim.

Ne gjithashtu do të paguajmë **kostot e mbrojtjes** por ne nuk do të paguajmë asnjë kosto për çdo pjesë të një pretendimi që nuk mbulohet nga ky seksion.

Shmangia e një pretendimi potencial kundër jush

Nëse klienti **juaj** ka baza të arsyeshme për t'u ndjerë i pakënaqur me punën që **ju** keni kryer, refuzon që të paguajë për ndonjë ose për të gjitha, duke përfshirë edhe shumën të cilat **ju** ia keni detyrim nënkontraktorëve në datën e refuzimit, dhe kërcënon që të fillojë një ankesë kundrejt **jush** për një shumë më të madhe sesa shumën që **ju** i detyroheni, mund të jetë e mundur zgjidhja e mosëmarrëveshjes me klientin me dakordësinë **tuaj** duke mos u bërë shkak shtytës ndaj shumës që po/do të trajtohet në mosmarrëveshje.

Nëse po, **ne** do t'ju paguajmë **juve** shumën që **ju** detyrohen **juve** në atë kohë nëse **ne** besojmë se kjo do të shmangë një ankesë legjitime për një shumë më të madhe dhe **ne** kemi dhënë miratimin **tonë** paraprak me shkrim për t'a zgjidhur në këtë mënyrë dhe për këtë shumë.

G.K.

P.S

Në mënyrë alternative, nëse nuk është e mundur arritja e një marrëveshjeje me klientin mbi këto baza por **ne** ende besojmë se duke mos shtyrë drejt shumë në mosmarrëveshje **ju** do të shmangni një pretendim legjitim ose kundërp pretendim për një shumë më të madhe, **ne** do të paguajmë shumë që ju detyrohet **juve** në atë kohë. Nëse pretendimi sillet gjithsesi, ne do të merremi me trajtimin e saj, por pagesa jonë totale, duke përfshirë shumën që tashmë ju kemi paguar juve ose në emrin tuaj, nuk do të tejkalojë kufirin e aplikueshëm të dëmshpërblimit që specifikohet në plan. **Ju** duhet të ktheni shumën që **ne** ju kemi paguar nëse **ju** përfundimisht riktheni borxhin minus shpenzimet **tuaja** të arsyeshme.

Në çastin kur **ne** biem dakord që ta kryejmë këtë pagesë **ju** do të na i caktoni **ne** të drejta të tilla siç keni në lidhje me shumën që ju detyrohen **juve**.

Ne nuk do të kryejmë asnjë pagesë për ndonjë pjesë të ankesës që nuk mbulohet nga ky seksion.

Vetë humbjet tuaja

Nëse gjatë **periudhës së sigurimit**, dhe në performimin e **aktiviteteve të punës suaj** brenda kufinjve gjeografikë, **ju** do të pësoni një humbje nga pandershmeria e punonjësve **tuaj** ose konsulentëve të vetëpunësuar të kontraktuar drejtpërsëdrejti për ju dhe nën mbikëqyrjen **tuaj**, ku ka pasur një qëllim të qartë për t'ju shkaktuar **juve** humbje ose dëmtim dhe për të marrë një fitim financiar sipër dhe poshtë çdo rroge, bonusi, ose komisioni, **ne** do t'ju dëmshpërblejmë **ju** kundrejt një humbje të tillë financiare të drejtpërdrejtë.

Cfarë nuk mbulohet?

Çështje specifike ndaj biznesit tuaj

A. Ne nuk do të kryejmë asnjë pagesë për asnjë pretendim ose humbje të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë për shkak të:

Çështjet e siguruara diku tjetër

1. operacionet **tuaja** ose administrimin e çdo pensioni ose skeme përfitimi punonjësish ose fondi besimi, ose shitjen ose blerjen ose marrëveshjet në çdo fond, aksion, ose letra me vlerë ose keqpërdorimin e çdo informacioni që lidhet me to, ose thyerja nga ana **juaj** e çdo legjislacioni ose rregulloreje lidhur me këto aktivitete.

2. thyerja nga ana **juaj** e çdo taksimi, konkurrence, kontrolli tregtie ose legjislacioni ose rregullatorësh të antitrust-eve.

3. çdo ndotje ose kontaminim, duke përfshirë zhurmën, fushat elektromagnetike, rrezatimin dhe valët e radiove.

4. transmissioni i një **virusi** në kompjuter.

5. përgjegjësia **juaj** nën çdo kontratë e cila është më e madhe sesa përgjegjësia që **ju** do të kishit në ligj pa kontratë, vetëm nëse keni marrë marrëveshjen **tonë** paraprake me shkrim.

6. aktivitetet e kryera në emër të një shoqërie, bashkim operatorësh ekonomikë ose skema me ndarje përfitimesh në të cilën **ju** bëni pjesë, vetëm nëse keni marrë marrëveshjen **tonë** paraprake me shkrim.

7. vdekja ose çdo dëmtim trupor ose mendor ose sëmundjeje e vuajtur nga çdokush, të tjera veç **neglizhencës**.

8. punësimi i çdokujt me ose pune për **ju**, ose çdo thyerje e një detyrimi nga **ju** si punëdhënës ose çdolloj diskriminimi, ngacmimi ose trajtimi të padrejtë.

9. zotërimin ose përdorimin e çdo toke ose godine, çdo kafshe, çdo aeroplani, mjeti lundrimi ose çdo automjeti me motor.

10. humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e çdo pronësie të prekshme.

11. çdo përgjegjësi personale e ndodhur nga një drejtor ose oficer **juaji** kur gjatë veprimin në atë kapacitet ose në menaxhimin e biznesit **tuaj**, ose thyerja **juaj** e çdo detyre të lënë në mirëbesim, tjetër përveç atyre të kryera gjatë performimit të

G.K.

P.S

një **aktiviteti biznesi** për një klient, ose çdo deklaratë, përfaqësim ose informacion lidhur me **ju** ose me biznesin **tuaj** të përmbajtur në llogaritë **tuaja**, në raporte ose në pasqyra financiare.

12. furniqimet **tuaja**, prodhimin, shitjen, instalimin ose mirëmbajtjen e çdo produkti.

13. shpifje.

Veprime të qëllimshme, të pakujdesshme, ose të pandershme

14. çdo veprim, thyerje, përjashtimi ose shkelje që **ju** e kryeni, që e harroni ose që e injoroni në mënyrë të qëllimshme, me dashakeqësi, pandershmëri, ose pakujdesi. Kjo nuk aplikohet ndaj ndonjë ankese ose të vetë humbjes **suaj** sipas pandershmërisë së mbuluar në atë që mbulohet, por **ne** nuk do të ofrojmë në asnjë rast mbulim ndaj çdo pale e cila faktikisht e kryen, e harron apo e injoron çdo pandershmëri.

15. performanca e çdo **aktiviteti biznesi** nga ju ndërsa jeni nën ndikimin e intoksikantëve ose narkotikëve.

Problemet paraekzistuese

16. çdo mangësi në punën **tuaj** ose vetë humbjet **tuaja** për të cilat **ju** keni pasur dijeni, ose që duhet të kishin qënë në dijeninë tuaj në mënyrë të arsyeshme, përpara se **ne** të binim dakord për sigurimin **tuaj**

Data e njohur

17. **data e njohur.**

Luftë, terrorizëm dhe bërthamore

18. **luftë, terrorizëm** ose **rreziqe bërthamore.**

Asbest

19. **rreziqet e asbestit.**

Pretendimet e sjella nga një palë **B. Ne** nuk do të bëjmë asnjë pagesë për: që lidhet me të

1. çdo ankesë e paraqitur nga një i siguar brenda përkufizimit **tuaj** ose të çdo pale me interesa financiare, ekzekutive ose menaxheriale ndaj **jush**, duke përfshirë çdo kompani mëmë ose çdo pale ndaj të cilave ju keni interesa financiare, ekzekutive ose menaxheriale, duke përfshirë çdo kompani në vartësi. Kjo nuk do të jetë e vlefshme ndaj një pretendimi të bazuar në përgjegjësinë ndaj një pale të tretë të pavarur që rrjedh drejtëpërsëdrejti si pasojë e performancës në **aktivitetin e biznesit tuaj.**

Të drejta të kufizuara rikthimi

2. ajo palë e çdo ankese ku e drejta **juaj** e rikthimit është e kufizuar nga çdo kontratë, vetëm nëse keni marrë marrëveshjen **tonë** paraprake me shkrim.

Humbje si pasojë

3. përfitimi **juaj** i humbur, ngritja e çmimit ose përgjegjësia për TVSH-në ose ekuivalenti i saj.

4. çdo humbje tregtare ose përgjegjësi tregtare duke përfshirë ato që ngrihen si pasojë e humbjes së një klienti, llogarie, ose biznesi/pune.

Pagesat e padetyrueshme

5. gjobot dhe penaltitetet kontraktore, dëmeve përkqesuese, ndëshkuese ose përjashtuese, dhe dëmeve shtesë sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta, Ligjit për Dizajnin industrial dhe Ligjin për Patentat, si dhe cdo ligji pasues.

Pretendimet jashtë gjykatave të aplikueshme

6. çdo ankesë, duke përfshirë arbitraritetin, sjellë jashtë vendeve të përcaktuara në planin nën Gjykatat e Aplikueshme.

Kjo do të jetë e vlefshme ndaj veprimeve në gjykatat e aplikueshme për të përforcuar ose që bazohen në, një gjykim ose vendim jashtë gjykatave të aplikueshme.

G. K.

P.S

Sa shumë do të paguajmë ne

Shuma më e madhe që **ne** do të paguajmë për totalin e të gjitha ankesave,

humbjeve dhe **kostove të mbrojtjes** është kufiri i vetëm i dëmshpërblimit të treguar në plan, pavarësisht numrit të ankesave. **Ju** duhet të paguani shumën e **tejkualuar** të treguar në planin për çdo pretendim, duke përfshirë **kostot e mbrojtjes**.

Të gjitha ankesat dhe humbjet që ngrihen nga e njëjta kauzë origjinle, një burim i vetëm ose një mungesë e përsëritur ose e vazhdueshme në punën **tuaj** do të konsiderohet si një pretendim. Kjo përfshin pretendimet dhe humbjet që ngrihen pas, si edhe gjatë, **periudhës së sigurimit**.

Pagesa jashtë kufinjve të dëmshpërblimit

Në çdo fazë të një pretendimi **ne** mund t'ju paguajmë **juve** kufirin e aplikueshëm të dëmshpërblimit ose të asaj çfarë mbetet pas çdo pagese të hershme nga ai kufi. **Ne** do të paguajmë **kostot e mbrojtjes** tashmë të ndodhura në datën e pagesës tonë. Më pas **ne** nuk do të kemi asnjë përgjegjësi tjetër për atë pretendim ose të **kostove të saj mbrojtëse**.

Detyrimet tuaja

Nëse do të ketë probleme

Ne nuk do të kryejmë asnjë pagesë nën këtë seksion:

1. vetëm në rast nëse **ju** do të na njoftoni **ne** menjëherë sipas pikave mëposhtë brenda **periudhës së sigurimit** ose në më të shumtën brenda 14 ditësh pas skadimit të saj për çdo problem mbi të cilin ju do të keni dijeni gjatë shtatë ditëve përpara skadencës:

a. dijeia **juaj** e parë për një mungesë në punën **tuaj** për një klient që ka të ngjarë që të çojë në ngritjen e një pretendimi kundër **jush**. Kjo përfshin çdo kritikë të punës **suaj** edhe pse ajo mund të konsiderohet nga ana **juaj** si e pajustificuar.

Nëse **ne** e pranojmë njoftimin **tuaj** ne do ta konsiderojmë çdo pretendim pasues si njoftim ndaj këtij sigurimi.

b. marrja e njoftimit nga çdo person që ka si qëllim që t'ju bëjë juve përgjegjës për çdo **neglizhencë**, pandershëmi, gabim ose përjashtim.

c. çdo letër, pretendim, urdhër gjygjësor, thirrje në gjyq ose të një procesi kundër **jush** për **neglizhencë** ose pretendim për **neglizhencë**.

d. zbulimi **juaj**, ose ekzistenca e bazave të arsyeshme për dyshimin **tuaj**, se ndonjë partner, drejtor, punonjës ose konsulent të vetëpunësuar ka vepruar me pandershëmi.

2. nëse, gjatë trajtimit me klientin **tuaj** ose të një pale të tretë, **ju** pranoni se **ju** jeni përgjegjës për atë që ka ndodhur ose bëni një ofertë, marrëveshje ose pagesë, vetëm nëse keni marrëveshjen **tonë** paraprake me shkrim.

Ju gjithashtu nuk duhet të tregoni shumën e mbulimit të disponueshëm sipas këtij sigurimi, vetëm në rast nëse **ju** duhet t'i jipnit këto detaje gjatë negociimit të një kontrate me klientin **tuaj** ose kur keni marrëveshjen **tonë** paraprake me shkrim.

3. vetëm në rast nëse **ju** në të gjitha kohët:

a. të mbani të dhëna përshkruese të përshtatshme për të gjitha shërbimet dhe paisjet profesionale të përdorura gjatë procedurave të cilat do të jenë të disponueshme për inspektim dhe përdorim nga **ne** ose përfaqësuesit e përcaktuar nga **ne** për këtë detyrë; dhe

b. të ruani të dhënat e referuara në pikën 3.a më sipër për një periudhe prej të paktën dhjetë vjeçare nga data e trajtimit dhe, në rast të një minoreni, për një periudhë prej të paktën dhjetë vitesh pasi ai minoreni të ketë arritur modhën madhore.

G.K.

P.S

Kontrolli i mbrojtjes

Ne kemi të drejtën, por jo detyrimin, që të marrim kontrollin dhe të kryejmë në emrin **tuaj**, hetimin, zgjidhjen ose mbrojtjen e çdo pretendimi. Nëse **ne** e mendojmë të arsyeshme **ne** do të caktojmë një person që do të merret me pretendimin(et), mbledhës ose çdo person tjetër të përshtatshëm për t'u marrë me pretendimin. **Ne** mund të emërojmë vetë mbledhësin **tuaj** por në të njëjtën bazë pagese si mbledhësi **ynë** dhe vetëm për punën e kryer me miratimin **tonë** paraprak me shkrim. Seancat do të mbrohen vetëm nëse ka një perspektivë të arsyeshme suksesi dhe duke marrë parasysh konsideratat tregtare të kostove të mbrojtjes.

Pranuar nga _____
(Emer, mbiemer, nenshkrim vule)

G.K.

P.S

Prishtinë, 22.03.2019

OFERTE PER SIGURIMIN E PERGJEGJESISE PROFESIONALE TE MJEKEVE

Kompania e sigurimeve "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" ushtron aktivitetin e saj në Kosovë që nga Tetori i vitit 2003, dhe është pjesë e grupit më të madh të sigurimeve "UNIQA GROUP" në Europën Qëndrore dhe Lindore, me një përvojë 150 vjecare në industrinë e sigurimeve.

Oferta e sigurimit profesional është paraqitur në bazë të përfitimeve dhe limiteve vjetore si dhe është e dedikuar për grup duke marrë parasysh numrin e paraqitur në kërkesë. Në rast të marrëveshjes me Odës dhe SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, anëtarët do të bëjnë sigurimin në baza vullnetare bazuar në kushtet e dakorduara me dy institucioneve.

Oferta është e dizajnuar për **përgjegjësinë profesionale të mjekëve** gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, të cilët mund të atakohen me rreziqe të ndryshme, ndër me të rëndësishmit ato të gabimeve të mundshme profesionale, ku këto gabime mund t'i bëjnë përgjegjës lirgjërisht ndaj palëve të treta.

Në këtë ofertë do të mbulon rreziqet si më poshtë :

- Dëme shëndetësore (përfshirë vdekjen, sëmundjen ose plagosjen) e ndonjë pacienti në lidhje me kërkesat për dëmshpërblim si rezultat i drejtpërdrejtë i neglizhencës, gabimit ose mosveprimit gjatë drejtimit dhe zbatimit të veprimtarisë të profesionistit shëndetësor.

G.K.

P.S

Opsioni 1

Specialiteti	Limiti i Pergjegjesise	Pjesa e Zbritshme	Primi Vjetor I Sigurimit
<ul style="list-style-type: none"> - Anaesthesiology and intense medicine - Surgery (cosmetic operations are not insured) - Women's medicine and birth help - Casualty surgery - Urology, (also andrology) - Tooth, mouth and jaw medicine 	<ul style="list-style-type: none"> - 30,000 EUR per cdo person ne semundje ose paaftesi e Perhershme dhe - 20,000 EUR per cdo person ne rast vdekje. - Mbulimi agregat per te gjitha ngjarjet gjate periudhes se sigurimit 30,000 EUR 	10% e cdo demi, Min. 1,000 EUR	400 EUR + Tvsh
<ul style="list-style-type: none"> - Ophthalmology, optometry, laser surgery - Neck, noses and ear diseases - Skin diseases and venereal diseases, dermatologists u. Allergist - Inside medicine - Cardiology - Children's surgery - Pneumology - Neurosurgery - Nuclear medicine - Orthopaedics and orthopaedic surgery - Radiology - Radiotherapy and Radio-oncology 	<ul style="list-style-type: none"> - 30,000 EUR per cdo person ne semundje ose paaftesi e Perhershme dhe 20,000 EUR per cdo person ne rast vdekje. - Mbulimi agregat per te gjitha ngjarjet gjate periudhes se sigurimit 30,000 EUR 	10% e cdo demi, Min. 1,000 EUR	400 EUR + Tvsh
<ul style="list-style-type: none"> - Industrial medicine and corporate medicine, hygiene and environmental physician - medical activity exclusively in laboratories - Histology - Hygiene and microbiology - Paediatrics and youth medicine (however, children's surgery like Surgery) - Early benefactor, handicapped educationist - Neuro-linguist, speech therapist - Neurology - Non-clinical medicine 	<ul style="list-style-type: none"> - 30,000 EUR per cdo person ne semundje ose paaftesi e Perhershme dhe 20,000 EUR per cdo person ne rast vdekje. - Mbulimi agregat per te gjitha ngjarjet gjate periudhes se sigurimit 30,000 EUR 	10% e cdo demi, Min. 1,000 EUR	350 EUR + Tvsh

G.K.

P.S

<ul style="list-style-type: none"> - General practitioner, holistic medicine - Psychiatry - Psychotherapy - Physical medicine, Med. Performance physiologists - Physical sports medicine (not, however, sport-orthopaedics and – traumatology) - Virology 			
---	--	--	--

Opsioni 2

Specialiteti	Limiti i Pergjegjesise	Pjesa e Zbritshme	Primi Vjetor i Sigurimit
<ul style="list-style-type: none"> - Anaesthesiology and intense medicine - Surgery (cosmetic operations are not insured) - Women's medicine and birth help - Casualty surgery - Urology, (also andrology) - Tooth, mouth and jaw medicine 	<ul style="list-style-type: none"> - 20,000 EUR per cdo person ne semundje ose paaftesi e Perhershme dhe - 15,000 EUR per cdo person ne rast vdekje. - Mbulimi agregat per te gjitha ngjarjet gjate periudhes se sigurimit 20,000 EUR 	10% e cdo demi, Min. 700 EUR	350 EUR + Tvsh
<ul style="list-style-type: none"> - Ophthalmology, optometry, laser surgery - Neck, noses and ear diseases - Skin diseases and venereal diseases, dermatologists u. Allergist - Inside medicine - Cardiology - Children's surgery - Pneumology - Neurosurgery - Nuclear medicine - Orthopaedics and orthopaedic surgery - Radiology - Radiotherapy and Radio-oncology 	<ul style="list-style-type: none"> - 20,000 EUR per cdo person ne semundje ose paaftesi e Perhershme dhe 15,000 EUR per cdo person ne rast vdekje. - Mbulimi agregat per te gjitha ngjarjet gjate periudhes se sigurimit 20,000 EUR 	10% e cdo demi, Min. 700 EUR	300 EUR + Tvsh

G.K.

P.S

<ul style="list-style-type: none"> - Industrial medicine and corporate medicine, hygiene and environmental physician - medical activity exclusively in laboratories - Histology - Hygiene and microbiology - Paediatrics and youth medicine (however, children's surgery like Surgery) - Early benefactor, handicapped educationist - Neuro-linguist, speech therapist - Neurology - Non-clinical medicine - General practitioner, holistic medicine - Psychiatry - Psychotherapy - Physical medicine, Med. Performance physiologists - Physical sports medicine (not, however, sport-orthopaedics and -traumatology) - Virology 	<ul style="list-style-type: none"> - 20,000 EUR per cdo person ne semundje ose paafesi e Perhershme dhe 15,000 EUR per cdo person ne rast vdekje. - Mbulimi agregat per te gjitha ngjarjet gjate periudhes se sigurimit 20,000 EUR 	<p>10% e cdo demi, Min. 700 EUR</p>	<p>250 EUR + Tvsh</p>
---	--	---	---------------------------

Departamenti I Pasurisë
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

G.K.

P.S

**Pyetesor per sigurimin e Përgjegjësise Profesionale nr. _____
Per Mjeke Profesioniste**

1. Emri dhe Adresa e të Siguararit	_____
2. Lloji i biznesit ose veprimtarisë së të Siguararit për të cilën do të zbatohet Sigurimi	_____
3. Eksperienca ne kete fushe Dhe bashkepunime te meparshme Sqaroni?	_____
4. Kufijtë e dëmshpërblimit:	
a) Per cdo ngjarje	_____
b) Ne agregat për të gjithë periudhën e sigurimit	_____
5. Pjesa e zbritshme	_____
6. Periudha e sigurimit	
nga	____/____/____
në	____/____/____
Data Retroaktive	____/____/____
7. Data e kërkesës	_____
8. A kane ndodhur deme per shkak te ushtrimit te profesionit gjate 5 viteve te fundit? Nese po sqaroni:	_____
9. Aplikanti nepermjet ketij pyetesorit garanton se, ne me te miren e njohurise te tij/saj, nuk ekzistojne fakte aktualisht te cilat ne menyre te arsyeshme te ngrejne pretendime ndaj kesaj police sigurimi?	
<input type="checkbox"/> Po, garantoj.	
<input type="checkbox"/> Jo. Nese jo, paraqisni detaje te kompletuara shoqerise sigurimit	
10. A ka qene i penalizuar gjate pese viteve te fundit nga Oda e Mjekëve të Kosovës per shkelje apo gabime gjate ushtrimit te profesionit ne perputhje me normat e Kodit te Etikes Profesionale dhe legjislacionit ne fuqi?	
Jo _____	
Po _____ Nese po sqaro me hollesi rrethanat	
Deklarimet e rreme apo te paverteta nga ana ime (noterit) perbejne kusht per mosmbulim ne sigurim te pergjegjesise ndaj paleve te treta per shkak te ushtrimit te profesionit. Shoqeria e sigurimit ne rast se vertetohet se deklarimet jane te rreme apo te paverteta eshte e cliruar nda cdo lloj detyrimi sipas polices sigurimit.	
11. Per sa me siper nenshkruan:	Dokumentacioni Bashkangjitur:
Kerkuesi / Aplikuesi	1. CV e Mjekut
_____	2. Licenca Profesionale e tij/saj
	3. Kopje e Kartes se anetaresimit te Oda e Mjkeve
	4. ID e mjekut
	5. PEP

G.K.

P.S